



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 069

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJËS NË MES TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE,
PUNËS DHE TRANSFEREVE DHE QEVERISË SË ZVICRËS
PËRFAQËSUAR NGA DEPARTAMENTI FEDERAL I PUNËVE TË
JASHTME PËRMES AGJENCISË ZVICËRANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM MBI PROGRAMIN MENAXHIMI I INTEGRUAR I
BURIMEVE UJORE NË KOSOVË**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJËS NË MES TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE DHE QEVERISË SË
ZVICRËS PËRFAQËSUAR NGA DEPARTAMENTI FEDERAL I
PUNËVE TË JASHTME PËRMES AGJENCISË ZVICËRANE PËR
ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM MBI PROGRAMIN MENAXHIMI I
INTEGRUAR I BURIMEVE UJORE NË KOSOVË**

Neni 1
Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen në mes të Republikës së Kosovës Përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve dhe Qeverisë së Zvicrës përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbi programin Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Kosovë.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Nëpërmjet këtij Ligji ratifikohet marrëveshja në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Zvicrës përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbi programin Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Kosovë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën e këtij Ligji është e bashkëngjitur marrëveshja mbi programin Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Kosovë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-069
13 dhjetor 2021

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës